

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

Pastrime Silvio

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K91413010N

NUIS/NIPT

Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I

Adresa

Tiranë

Albania

1010

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0686058899

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

financa@pastrimesilvio.com

E-mail

Administrator Bule Allmuça

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/05/30

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355686058899

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-48784-05-23-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tirane

Vlera e përlllogaritur e prokurimit

Vlera e përlllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

54161860

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/06/25

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

2025/05/30

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2025/06/25

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-48784-05-23-2025

98341110-9

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit për prokurimin publik”, e ndryshuar

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër ☐

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Me date 26.05.2025 është publikuar procedura e hapur e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirembajtjen e objekteve specifike”, parashikuar për të zhvilluar me date 25.06.2025

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Ne procedurën e publikuar me date 26.05.2025 me objekt “Shpenzime për mirembajtjen e objekteve specifike”, me fond limit 54,161,860.31 leke pa tvsh, pas shqyrtimit të dokumentacionit të publikuar nga autoriteti kontraktor, gjykojmë që disa nga kriteret e kërkuara janë të pajustificuara teknikisht dhe të pabazuara në ligj, e si të tilla duhet të ndryshohen ose edhe të hiqen.

Me konkretisht, i listojmë ne vijim:

Kriteri 2.1.1 ku kerkohet “Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të leshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NP - 3 B Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale;
- NS - 4 B Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to etj.”

Kategoritë e kërkuara janë të tipit “B”, që sipas rregullores së licencimit të miratuar me VKM nr. 408/2015, e ndryshuar, nënkuptojnë kapacitete me të mëdha financiare, organizative dhe teknike, të përshtatshme për projekte me kompleksitet të lartë ndërtimor.

Ne procedurën konkrete, objekti është “shërbim lëvizës dhe mirembajtje”, jo rikonstruksion, dhe nuk përfshin as ndërhyrje në struktura, as ndërtim, as përmirësim të performancës konstruktive. Siç përcaktohet nga vete AK në shtojcën 8 të Termave të Referencës:

- Qëllimi i Shërbimit të lëvizës: Bojatisje, higjienizimi, pastrimi dhe ripërtëritje e ngjyrave në sipërfaqet e mureve të brendshme dhe të jashtme të objekteve shkollore.
- Objekti i Shërbimit të lëvizës: Të mundësojë lëvizjen me çilesi dhe në kohë, duke përdorur bojra e materiale ekologjike dhe të standartizuara, në objektet shkollore të Bashkisë Tiranë, të sipërfaqeve të mureve të brendshme dhe të jashtme dhe tavanet, sipas listës së objekteve të sipërcituar.

Për më tepër, kerkohet që të kryhen punime bojatisjeje të sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme e suvatime, jo punime strukturore. Gjithashtu, në praktiken e zakonshme të APP-së dhe AKPT-së, për punë të tilla zakonisht kerkohen liçensa NP-3A ose NS-4A, të cilat janë për punime të ngjashme por me volum dhe kompleksitet më të ulët.

Neni 77, pika 1 e ligjit nr. 162/2020, e ndryshuar përcakton që “Te gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Po ashtu, në VKM-në nr. 285/2021, e ndryshuar, theksohet se kërkesat për dokumentacion dhe kapacitete teknike duhet të jenë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës dhe të provueshme me dokumentacion objektiv.

Kërkesa për kategori “B” për shërbime elementare mirembajtjeje bie ndesh me të dy këto parime dhe është e pajustificuar dhe kerkojmë modifikimin e këtij kriteri.

Kriteri 2.3.3 ku kerkohet “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 120 (njëqind e njëzet) punonjësve për periudhën Shkurt 2025 – Prill 2025 dhe në vazhdim, të vertetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj;

- Listepagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shkurt 2025 – Prill 2025.”

Nderkohe qe ne piken 2.3.3 si me lart kerkohet nje total prej 120 punonjesish, ne specifikimet ne vijim kerkohen punonjes te tille si:

? 21 bojaxhinj

? 12 punonjes per lartesi

? 5 suvatures

? 5 punonjes per murature

? 4 punonjes per sistemime, etj.

Numri total i stafit te specializuar sipas ketyre perlllogaritjeve, nuk e kalon pragun prej 60-70 vetash.

Prandaj kerkesa per 120 punonjes eshte e ekzagjeruar dhe jo e lidhur me nevojen reale te punes.

Per me teper, ne Shtojcen 8 “Formulari i termave te references”, vete AK ka percaktuar qe

“Kontrata zbatohet me plane te programuara mujore duke mbajtur kontakte te perditshem me perfaqesues te AK te ngarkuar per ndjekjen e procedures se zbatimit te kontrates, procedure me te cilin OE njihet zyrtarisht nga AK me fillimin e zbatimit.”, çka do te thote se sidoqofte, punonjesit nuk jane te nevojshem te gjithë njekohesisht, pasi do te punohet sipas nje plani te percaktuar paraprakisht, ne menyre periodike, ku mund te menaxhohen edhe punonjesit dhe shperndarja e tyre neper objekte te ndryshme.

Ne nenin 77, pika te te ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, percaktohet qe kriteret duhet te jene proporcionale dhe te lidhen drejtperdrejt me objektin e kontrates dhe te jene te justifikueshme

Kerkesa per 120 punonjes, eshte pa baze teknike dhe ligjore, dhe kufizon pjesemarrjen e

operatoreve te mesem dhe me te vegjel, ne shkelje te nenit 3 te ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar.

Per keto arsye, kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe uljen e numrit te punonjesve te kerkuar.

Kriteri 2.3.4 ku kerkohet “Operatoret ekonomike ofertues, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponojne personelin kryesor, drejtues teknik ne licencen e shoqerise, dhe te figurojne ne listepagesen e subjektit per muajin e fundit, dhe ne vazhdim, si me poshte:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi,

- 1 (nje) Arkitekt.

Per kete operatoret ekonomike duhet te paraqesin:

- Kontrate pune e vlefshme, Diplome.

- Listepagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.”

E konsiderojme te panevojshme dhe te paarsyetuar kerkesen per arkitekt pasi, arkitekti eshte

projektues, dhe perdoret ne kontrata te projektimit apo ne zbatim te puneve qe ndryshojne

infrastrukturen apo strukturen e objekteve. Ne kete procedure kerkohet vetem sherbim lysterje dhe mirembajtjeje, ku nuk ka nevoje per projektim apo per vizatime arkitektonike. Keto lysterje kryhen mbi siperfaqe ekzistuese pa nderhyrje ne elemente konstruktive apo artistike qe kerkojne supervizim projektues

Ne nenin 41, pika 2 e VKM-se nr. 285/2021, e ndryshuar, percaktohet se “Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates”. Ne kete rast, arkitekti nuk kontribuon ne ekzekutimin teknik te sherbimit te kerkuar, prandaj kjo kerkese eshte e panevojshme, eshte jashte objektit te kesaj procedure prokurimi dhe eshte kufizues ndaj operatoreve ekonomike te interesuar per te marre pjese ne kete procedure dhe kerkojme qe te hiqet.

Kriteri 2.3.5 ku kerkohet “Operatoret ekonomike ofertues, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponojne personelin staf mbeshtetes, dhe te figurojne ne listepagesen e subjektit per muajin e fundit dhe ne vazhdim,ose me kontrate bashkepunimi si me poshte:

- 1 (nje) Inxhinier Materialesh”

Edhe kete kerkese e konsiderojme te panevojshme, pasi Inxhinieri i materialeve eshte specialist i nevojshem ne ndertime te reja, vleresime laboratorike, apo perzgjedhje te materialeve inxhinierike te nderlikuara (beton, çelik, etj.). Ne kete rast, kemi bojatisje e suvatim, ku materialet jane te thjeshta, te gatshme dhe standarde tregu.

Per me teper, po zhvillohet nje procedure paralele me objekt “Blerje materiale bojaxhiu” me nr. REF-48753-05-22-2025, çka nenkupton qe operatori ekonomik nuk do te perzgjedhe, as nuk do te analizoje materialet, por vetem do t’i aplikojë ato. Pra, kerkesa eshte pa funksion praktik dhe teknik.

Kjo kerkese nuk eshte objektive dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe lidhjen e drejtperdrejte me objektin e prokurimit, dhe si e tille kerkojme qe te hiqet si kriter.

Kriteri 2.3.6 ku kerkohet “Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si staf teknik punonjes, te pajisur me diploma/çertifikata te arsimit profesional te leshuara nga institucionet te akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise” ose ekuivalente si dhe te rezultojne ne listepagesen e subjektit per muajin e fundit dhe ne vazhdim, minimumi:

- 21 (njezet e nje) punonjes bojaxhi
- 5 (pese) punonjes suvatues
- 5 (pese) punonjes teknik ndertimi
- 2 (dy) punonjes specialist per sisteme te thata
- 6 (gjashte) punonjes per veshje fasade (sistemi kapot)

Per keta punonjes, ofertuesi duhet te paraqese:

- Listepagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.
- Kontraten individuale te punes te vlefshme;

Dokumentacionin qe te vertetoje kualifikimin profesional te kerkuar ne kete kriter.

(diplome/çertifikate e arsimit profesional) leshuar nga institucione (shteterore apo private) te licencuara/akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”.

Lista e gjate me bojaxhinj, suvatues, elektrike, muratore per sistemime etj., eshte disproporcionale per nje kontrate qe ka per objekt sherbimin e mirembajtjes dhe lyerjes ne nje sasi dhe kompleksitet te caktuar. Kerkesa qe te gjithë keta punonjes te jene te regjistruar ne listepagesa, me kontrata pune dhe te kene certifikata te licencuara nga institucionet shteterore, krijon barriera te panevojshme per operatorët ekonomike, sidomos ata qe punojne ne forma fleksibile ose me kontrata bashkepunimi. Per me teper, kriteret shkojne pertej objektit te kontrates, duke detyruar operatorët te paraqesin staf shume specifik, edhe pse puna ka natyre mirembajtjeje e thjeshte. AK nuk ka analizuar mjaftueshem nese keto kerkesa jane ne harmoni me natyren e kontrates. Nuk ka marre ne konsiderate fleksibilitetin e tregut te punes dhe menytrat alternative te angazhimit te stafit teknik qe jane te ligjshme. Per kete arsye, kerkojme modifikimin e ketij kriteri.

Kriteri 2.3.7 ku kerkohet “Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar te pakten 2 (dy) punonjes te cilet te jene te pajisur me çertifikaten e trajnimit si Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” ose ekuivalente dhe te figuroje ne listepagesat e operatorit ekonomik ofertues per muajin e fundit dhe ne vazhdim, ne perputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18.02.2010 Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 Per miratimin e rregullores Per sigurine ne kantier . Per punonjesin e mesiperm duhet te paraqitet kontrata e punes e vlefshme dhe deshmia perkatese e leshuar nga ente çertifikuese te akredituara/liçensuara”

Ligji nr. 10237/2010 “Per sigurimin ne pune” kerkon qe ne çdo vend pune te jete caktuar nje pergjegjes per sigurine, dhe jo me shume, perveç rasteve me disa kantiere njekohesisht. Ne kete

rast kemi nje kontrate sherbimi ne objekte arsimore, dhe jo nje projekt masiv ndertimi. Nje pergjegjes eshte i mjaftueshem.

Kerkesa per 2 pergjegjes bie ndesh me ligjin dhe VKM-ne per prokurimin publik dhe eshte e pajustificuar ligjerisht dhe teknikisht, dhe per kete arsye kerkojme modifikimin e ketij kriteri.

Kriteri 2.3.8 ku kerkohet “Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar te pakten 12 (dymbedhete) punonjes te cilet te jene pajisur me çertifikaten e trajnimit Per punimet ne lartesi/montim skelerie“ ose ekuivalente, ne perputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18.02.2010 Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 Per miratimin e e rregullores Per sigurine ne kantier dhe te figuroje ne listepagesat e operatorit ekonomik ofertues per muajin e fundit dhe ne vazhdim. Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqitet kontrata e punes e vlefshme dhe deshmia perkatese e leshuar nga ente çertifikuese te akredituara/liçensuara.”

Kerkesa per 12 punonjes me certifikate per lartesi nuk provohet, pasi nuk argumentohet nevoja per kaq shume punonjes njekohesisht me certifikate per punime ne lartesi. Nuk jepet liste objektesh qe e kerkojne kete. Ne DST nuk percaktohet asnje vleresim risku, lartesi objektive, apo kohezgjatje te punimeve ne lartesi. Si me teper sqaruar, per sa kohe qe do te punohet mbi planifikime mujore, nuk do te jete e nevojshme qe nje numer kaq i madh punonjesish te jene te gatshem ne te njejten kohe. Per kete arsye, kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe zvogelimin e numrit te punonjesve per punime ne lartesi.

Kriteri 2.3.9 ku kerkohet “Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar per te gjithë materialet te cilat do te perdoren per zbatimin e kontrates te cilat jane te pasqyruara ne Shtojcen 6 Formulari i Specifikimeve teknike (publikuar ne SPE). Ne rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet te vertetohet lidhja ndermjet distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ebsite kjo nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”

Autorizimi kerkohet zakonisht kur operatori furnizon materiale, per te garantuar cilesi dhe origjine. Ne kete rast, boja do te blihet nga vete autoriteti, ne nje procedure tjeter me objekt “Blerje materiale bojaxhiu” me nr. REF-48753-05-22-2025 dhe operatori ekonomik qe do te shpallet fitues, thjesht “e aplikon” bojen qe i jepet. Kjo kerkese krijon konfuzion dhe nderlikon tenderin e sherbimit me ate te furnizimit, duke detyruar operatoret te lidhen me distributore te caktuara, gje qe shkel konkurrencen. Prandaj, autorizimi nuk ka funksion dhe eshte nje kerkese pa lidhje me objektin e kesaj procedure. Per me teper, kemi te bejme me nje procedure sherbimi dhe jo me procedure furnizimi me materiale.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e ketij kriteri.

Kriteri 2.3.10 ku kerkohet “Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese per te gjithë materialet te cilat do te perdoren per zbatimin e kontates te cilat jane te pasqyruara ne Shtojcen 6 Formulari i Specifikimeve teknike (publikuar ne SPE), katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve leshuara/publikuara nga prodhuesit/distributoret zyrtare ose skedat teknike te leshuara/publikuara nga prodhuesit/distributoret zyrtare, ku te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet te permbaje karakteristikat teknike te mallrave sipas kerkesave te DST me qellim qe autoriteti kontraktor te gjykoje nese materialet te cilat do te perdoren ne kryerjen e sherbimeve, plotesojne kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit.”

Skedat teknike kerkohen per te vleresuar karakteristikat e produkteve qe do furnizohen. Por, nese produktet nuk do te sigurohen nga operatori, por nga autoriteti kontraktor, atehere nuk ka asnje arsye qe operatori i sherbimit te paraqese skeda teknike. Per sa kohe qe, sic eshte permendur dhe

me siper, keto materiale do te sigurohen nepermjet nje procedure tjeter prokurimi, eshte absurde qe te kerkohen skeda teknike ne kete rast (e njejta gje edhe per Autorizimin e prodhuesit, kataloget, Certificate CE). Ka nje perzierje te kriterëve ndërmjet procedures per sherbime dhe procedures per furnizim me mallra, ku ne kete rast keto kërkesa do te ishin te justifikueshme dhe ligjore, por jo ne kete rast.

Per kete arsye kerkojme heqjen e ketij kriteri.

Kriteri 2.3.11 ku kerkohet “Me qellim vertetimin e permbushjes se standarteve teknike te kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Deklarate/Certifikate Konfirmimit CE ose Ecolabel ose raportet e testimit te leshuara nga ente certifikues te akredituar per materialet te cilat do te perdoren ne sherbimet e mirembajtjes te parashikuara sipas preventivit te publikuar, per te cilet jane kerkuar standarte teknike kombetare apo nderkombetare te miratuara, te specifikuara ne Shtojcen 6 Formulari i Specifikimeve Teknike (publikuar ne SPE), me qellim vertetimin e permbushjes standarteve teknike te kerkuara.”

Deklarata/Certifikata CE vlen per importues apo furnitore te produkteve qe permbushin standardet evropiane. Por, ne kete rast, nuk do te behet furnizim me boje, por sherbim lyerje. Furnizimi me boje ku mund te jene te arsyeshme keto kërkesa, jane te pershtatshme ne proceduren tjeter me objekt “Blerje materiale bojaxhiu” me nr. REF-48753-05-22-2025.

Ky kriter nuk eshte ne perputhje me objektin e kesaj procedure (ashtu si dhe kriteret 2.3.9, 2.3.10) dhe bien ndesh me parashikimet ligjore te ligjit dhe VKM-se per prokurimin publik, e per kete arsye kerkojme heqjen e ketij kriteri.

Kriteri 2.3.14, germa “b” ku kerkohet “Ne rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore te blerjes dhe kur ato jane te marra me qera te paraqitet kontrata e qirase ku te specifikohet objekti i kontrates dhe afati i saj si edhe dokumentat qe vertetojne pronesine e qiradhenenesit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore te blerjes, si dhe per per pajisjet rripa sigurimi, platforme ngritese teleskopike mbi 25m, platforme ngritese teleskopike mbi 15m, platforme ngritese gershere mbi 15m, duhet te paraqesin certificate te vlefshme inspektimi te leshuar nga nje organ i akredituar/licensuar.”

Kerkohet te disponohen Platforme ngritese teleskopike mbi 15 m, Platforme ngritese me sistem gershere mbi 15 m, Certificate inspektimi e vlefshme nga organ i licencuar/akredituar.

Ne asnje pjese te DST-se nuk percaktohet qe objektet do te lyhen jane ne lartesi mbi 15 m. Per me teper, shumica e shkollave apo kopshteve jane 1–3 kate, qe do te thote 3–10 m lartesi. Nuk ka as plan punimesh, as liste objektesh, as preventiv qe te justifikojë kete kërkesë. Kërkesa per platforma ngritese teleskopike apo gershere mbi 15m eshte e tepruar dhe pa lidhje me nevojën reale (duke pasur parasysh edhe faktin qe jane kerkuar edhe platforma ngritese teleskopike mbi 15 metra).

Kërkesa per certificate inspektimi te vlefshme eshte e paarsyeshme ne kete rast, per shkak te mungeses se nevojës, duke e bere nje barre te panevojshme ekonomike dhe pengese per konkurrencen.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

Jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

financa@pastrimesilvio.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Bule Allmuça